

STATUTI

I SHOQERISE SE BASHKEPUNIMIT

BUJQESOR "Juljano 13 Medicinal"

Në mbështetje të ligjit nr. 38 date 05.04.2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor" si

dhe ligjit nr. 9723 datë. 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" hartohet ky Statut i Shoqërisë "Juljano 13 Medicinal".

Kjo shoqëri është një organizëm jo politik dhe i pavarur i krijuar me vullnetin e lirë të

anëtarëve të saj.

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Emërtimi i shoqërisë do të jetë Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor "Juljano 13 Medicinal".

Inicialet e Shoqërisë do të jenë SHBB "J.13.M."

Shoqëria ka vulën dhe logon e saj dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2


OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i Shoqërisë është :

- Punime bujqesore te te gjitha llojeve.
- Mbjelljes, rritjes dhe përpunimit të të gjitha prodhimeve bujqësore dhe medicinale te te gjitha llojave që gjenden në territorin ku vepron shoqëria për të realizuar sasi më të mëdha prodhimi për të hyrë në treg dhe për të rritur çmime më konkurruese për shitjen e tyre, për shkak të madhësisë së madhe në krahasim me rastin kur kjo punë do të kryhej nga një individ i pavarur.
- Prodhimit te farerave, rritjes se fidaneve te bimeve medicinale dhe tregëtimi tek fermeret e tjere.
- Prodhimit, përpunimit, paketimit, prodhimit te esencave, te bimeve medicinale dhe eksportit te tyre .
- Prodhimit dhe instalimit te impianteve te tharrjes se bimeve medicinale.
- Import - eksport i të gjitha prodhimeve bujqësore mjekesore të përpunuara (industrializuara) e të freskëta, të gjalla, blerjes së farnave, fidanave, medikamenteve të ndryshme për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- Nxitjen dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregëtimin e prodhimeve të fermerëve.
- Sigurimin dhe furnizimin e fermerëve me impute cilësore dhe me çmime të favorshme.

NENI 3

PERGJEGJESIA E SHOQERISE



Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me të gjithë pasurinë e saj aktuale apo të ardhshme.

Ortakët e shoqërisë janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë deri në vlerë e kontributit të tyre të nëshkruar në kapitalin e shoqërisë.

NENI 4

SELIA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISE

Selia e Shoqërisë do të jetë me adrese në: Kronit 03700030; Nd. 4; H. 1; Shkrel; Dedaj; 4305; Malësi E Madhe.

Veprimtaria e saj do të shtrihet në Komuna/Prefektura/Qarku SHKODER, si dhe kudo ku shtrihet anëtarësia e saj.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë "MBI 10 (DHJETE) VJET" është e pakufizuar.

NENI 6


KUSHTET E PRANIMIT DHE LARGIMIT TE ANETAREVE

1. Shoqëria ka një numër minimal prej 8(tetë antarësh).
2. Në Shoqëri ka të drejtë të anëtarësohet çdo individ, person fizik apo juridik që pranon programin dhe statutin e shoqatës dhe paguan kontributin përkatës në kapitalin e shoqërisë.
3. Pranimi i anëtarëve të rinj bëhet nga Asambleja e Anëtarëve pas kërkesës për anëtarësim që i drejtohet Administratorit të Shoqërisë.
4. Pasi merret miratimi paraprak për anëtarësim, anëtari i ri në mënyrë që të bëhet anëtar me të drejta të plota duhet të paguajë pjesën përkatëse të kontributit në kapitalin e shoqërisë.
5. Në rast se antari i miratuar nga Asambleja nuk paguan kontributin në kapital brenda 30 ditësh kalendarike nga dita e miratimit atëherë miratimi humbet vlerën juridike dhe kërkuesi duhet të aplikojë nga e para.
6. Gjatë periudhës 30 ditore Anëtari i miratuar nga asambleja nuk ka të drejtë pjesëmarrjeje dhe as vendim marrjeje në shoqëri. Kjo e drejtë fitohet vetëm pas pagesës së kontributit përkatës në kapital.

NENI 7

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ANETAREVE

1. Anëtarët kanë të drejta dhe detyrime të përcaktuara qartë.
2. Anëtarët kanë të drejtën të propozojnë dhe miratojnë ndryshime në organikën si dhe rregullat e funksionimit të brendshëm të Shoqërisë.



3. Anëtarët kanë të drejtë të propozojnë dhe miratojnë ndryshime në statut.
4. Anëtarët e shoqërisë kanë të drejtë të informohen në çdo moment për mbarëvajtjen e shoqërisë si dhe kanë të drejtën të kenë akses në çdo dokument të shoqërisë.
5. Antaret kanë detyrimin të marrin pjesë në mbledhjet e asamblese së antareve të shoqërisë.
6. Anëtarët kanë të drejtën të largohen në çdo kohë nga Shoqëria sipas procedurave të specifikuara në këtë statut.
7. Anëtarët kanë detyrimin të paguajnë kontributin përkatës në kapitalin e shoqërisë.
8. E drejta e anëtarësisë në shoqëri mund të tjetërsohet duke u dhuruar, shitur apo të kalohet me anë trashëgimie por gjithmonë në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor".
9. Çdo anëtar ka të drejtë të shfaqë mendimet e tij, të diskutojë në mbledhje, të kërkojë llogari për harxhimin e fondeve, të kundërshtojë në Gjykatën Kompetente vendimet e shoqërisë që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe statutin brenda një muaji nga dita që ka marrë njoftimin për atë vendim.
10. Anëtarët kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin e administratorit të shoqërisë, të informohen për llogaritë vjetore financiare, për raportet e ekspertëve kontabël, mënyrat dhe procedurat e ndarjes së fitimit, raportin e veprimtarisë së shoqërisë si dhe çdo të drejtë apo detyrim tjetër që është parashikuar në Ligj.

NENI 8


RIMBURSIMI I ANETAREVE TE LARGUAR APO PERJASHTUAR

1. Anëtarët që kanë dhënë dorëheqjen ose janë përjashtuar nga shoqëria kanë të drejtën të rimbursohen për pjesën e tyre të kapitalit me përjashtim të rastit kur kanë detyrime të pashlyera kundrejt Shoqërisë apo kur i kanë sjellë një dëm financiar të konfirmuar shoqërisë.
2. Rimbursimi do të bëhet pa prekur pjesën e kapitalit minimal prej 100.000 Leke të përcaktuar nga Ligji.
3. Rimbursimi i Anëtarit bëhet jo më vonë se 5 vjet nga dita e largimit të Anëtarit apo përjashtimit të tij nga Shoqëria.
4. Në rast të kalimit të afatit 5 -vjeçar, Anëtari i larguar apo i përjashtuar ka të drejtën ta kërkojë rimbursimin në rrugë gjyqësore.

NENI 9

OFRIMI I SHERBIMEVE

1. Shoqëria ofron shërbimet e saj jo vetëm për anëtarët e saj por edhe për individë, persona fizikë apo juridikë jo anëtarë. Për personat jo anëtarë ofrimi i shërbimeve nga Shoqëria do të jetë me vlerë jo më të ulët sesa çmimet e tregut.
2. Në çdo rast, të ardhurat që shoqëria krijon si pasojë e ofrimit të shërbimeve të saj jo-anëtarëve, nuk duhet të kalojnë 40 % të totalit të të ardhurave të shoqërisë.



NENI 10

KAPITALI

1. Kapitali minimal i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Leke te reja, ndarë secili nga nga 1 (nje)kuote. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kontributet e anëtarëve të cilat mund të jenë në para ose në natyrë.
2. Kapitali ndahet në pjesë të cilat zotërohen nga anëtarët dhe përfaqësojnë vlerën e kontributit të tyre në kapital.
3. Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazën e një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert.
4. Anëtarët janë pronarë të asetëve të tyre në kapitalin e shoqërisë duke qënë kështu dhe pronarë të Shoqërisë në raport me kontributet në kapital.
5. Kapitali përkatës mund të shitet, dhurohet apo lihet në trashëgimi nga secili prej anëtarëve të Shoqërisë.
6. Kapitali mund të ndryshojë me anë të kontributeve shtesë të anëtarëve aktualë, me shtimin e numrit të anëtarëve, me kapitalizimin e fitimeve apo me çdo mënyrë tjetër të ligjshme.

Në momentin e krijimit të Shoqërisë kapitali fillestar është i ndarë si më poshte përcaktuar;

1. Z. Pjeter Çukaj, - 30%	(30.000 dyzet mije leke te reja)
2. Z. Roland Kalaj, - 10%	(10.000 dhjete mije leke te reja)
3. Z. Elvis Çukaj, - 10%	(10.000 dhjete mije leke te reja)
4. Zj. Ersila Çukaj, - 10%	(10.000 dhjete mije leke te reja)
5. Zj. Drita Çukaj, -10%	(10.000 dhjete mije leke te reja)
6. Z. Mirash Çelaj, - 10%	(10.000 dhjete mije leke te reja)
7. Z. Robert Preknica -10 %	(10.000 dhjete mije leke te reja)
8. Z. Ardit Vulaj - 10 %	(10.000 dhjete mije leke te reja)
TOTALI = 100%	(100.000 njëqind mijë leke te reja)

7. Çdo anëtar ka detyrimin të shlyejë plotësisht vlerën e kontributit të tij në momentin e anëtarësimit.

NENI 11

TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. Pjesa e kapitalit në shoqëri fitohet ose transferohet duke pasur parasysh përcaktimet

e Ligjit nr. 38 datë 04.05.2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor", nëpërmjet:

a) nënshkrimit të kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) dhurimit;

c) trashëgimisë, kur të interesuarit kërkojnë të jenë anëtarë. Transferimi i pjesës tek të interesuarit, të cilët gëzojnë cilësinë e trashëgimtarit dhe që kërkojnë të jenë anëtarë, bëhet brenda gjashtë muajve nga vdekja e anëtarit. Në rastet kur nuk përmbushet kushti i sipërpërmendur, ata kanë të drejtë të kërkojnë likuidimin e pjesës përkatëse;

d) çdo formë, të parashikuar me ligj.

IKA E SHQËRIE
SHPËRIMTARIE

NENI 12

FONDI I REZERVES SE DETYRUESHME

1. Shoqëria krijon fondin e rezervës së detyrueshme, i cili destinohet për konsolidimin dhe garancinë e kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor e të aftësisë paguese të saj dhe është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të Ligjit nr. 38 datë 04.05.2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".
2. Fondi i rezervës së detyrueshme krijohet nga derdhja në këtë fond e jo më pak se 15 për qind të fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura, në masën derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me kapitalin e shoqërisë, sipas nenit 27 të Ligjit nr. 38 datë 04.05.2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor"

NENI 13

FONDI I PERBALLIMIT TE RISKUT

1. Shoqëria krijon fondin e përballimit të riskut, që shërben për përballimin nga shoqëria të rreziqeve apo dëmeve të çfarëdolloj natyre, me të cilat mund të përballlet veprimtaria e shoqërisë, përfshirë këtu edhe fenomenet natyrore apo ato dëme dhe risqe, të cilat janë të lidhura me vetë llojin e veprimtarisë ose të produktit.
2. Shoqëria depoziton në fondin e përballimit të riskut një përqindje të fitimit të saj, e cila përcaktohet në statut, por që nuk mund të jetë më pak se 10 % e fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura. Ky fond është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të Ligjit nr. 38 datë 04.05.2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".

NENI 14

DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI

1. Shoqëria mban të dhënat e veprimtarisë së saj në:
 - a) regjistrin e anëtarëve;
 - b) regjistrin e vendimeve të organeve të saj;
 - c) regjistrat për veprime financiare dhe kontabël
2. Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.
3. Administratori përgatit raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël, të cilat i paraqiten asamblesë së përgjithshme për miratim.
4. Mbajtja e regjistrave të shoqërisë është nën përgjegjësinë e administratorit. Mënyrat dhe afatet e ruajtjes së tyre përcaktohen në rregulloret e brendshme të Shoqërisë.



5. Ekspert Kontabël i Shoqërisë caktohet për një periudhë dy vjeçare zj. ELIRA QAMIL ÇAKU(Memeli) me adrese rr Bulevardi i Pare, Parruce Shkoder, me nipt L16318002B.

NENI 15

ORGANET DREJTUESE, MENYRA E FORMIMIT, KOMPETENCAT

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e përgjithshme dhe;
2. Administratori

I. Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është organ vendimmarrës dhe përbehet nga të gjithë anëtarët e shoqërisë.
2. Asambleja zgjedh me shumicën e thjeshtë të antarëve të saj kryetarin dhe njeheri Administratorin, i cili do të jete **Z. Pjeter Çukaj**, dhe sekretarin **Zj. Drita Cukaj**, të cilët qëndrojnë në pozicionet e tyre për një periudhë 5 -vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Asambleja e përgjithshme ka këto kompetenca:

- vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;
- analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që konsiderohen të rëndësishme;
- emëron dhe shkarkon administratorin, ekspertin/et kontabël dhe likuiduesin/it, si dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre;
- miraton zvogëlimin apo zmadhimin e kapitalit;
- miraton ndryshime të statutit;
- vendos për shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të ligjit dhe statutit;
- vendos shkëputjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë;
- vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
- vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre;
- miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël dhe të likuiduesve;
- miraton pranimin e anëtarëve të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe largimin apo përjashtimin e tyre;
- kryen detyra dhe çështje të tjera të përcaktuara në ligj

Për çështjet që shqyrton, asambleja e përgjithshme merr vendimet përkatëse, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, çdo kuotë në kapital është baraz me të drejtën e një vote.

Thirrja e asamblesë, mënyra e votimit, përfaqësimi dhe kuorumi bëhet sipas procedurave

të përcaktuara në Ligjin nr. 38 datë 04.05.2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor".

II. Administratori

Administratori është personi i cili ka përgjegjësi për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë. Ai përfaqëson shoqërinë në lidhje me palët e treta.

Administratori qëndron në detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Kompetencat kryesore të Administratorit janë:


- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikën e përcaktuar nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqëson shoqërinë;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijon një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas Ligjit nr. 38 datë 04.05.2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor".
- Raporton në Asamble sipas kërkesave të asamblesë së anëtarëve; Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo moment me shumicë të thjeshtë, pa u trajtuar kjo si ndryshim i statutit. Administratorit, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

NENI 16

PRISHJA E SHOQERISE SE BASHKEPUNIMIT BUJQESOR

Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme:

- 1) përfundimi i afatit të shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit;
- 2) vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
- 3) përmbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përmbushur atë;
- 4) zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
- 5) bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- 6) reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmuajore;
- 7) nisja e procedurave të falimentimit;
- 8) mosushtimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjoftimi i pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- 9) nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- 10) me vendim të gjykatës;
- 11) për çdo arsye tjetër, të përcaktuar në ligj.



NENI 17
LIKUIDIMI

1. Përveç rasteve kur kundrejt shoqërisë është hapur një procedure falimentimi ndaj personit juridik, sipas dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", të ndryshuar, verifi kimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 15 të këtij Statuti, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30 ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdues.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likujduesit, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.
4. Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit të emëruar sipas paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
5. Likujduesi emërohet nga gjykata në rastet kur shoqëria priset me vendim të gjykatës.

NENI 18

Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ditë në të cilën shoqëria njihet edhe si person juridik.

PERFAQESIA THEMELUESE

- | | | |
|---|---|---|
| 1. Z. Pjeter Çukaj
<i>Pjeter Çukaj</i> | 2. Z. Roland Kalaj
<i>Roland Kalaj</i> | 3. Z. Elvis Çukaj
<i>Elvis Çukaj</i> |
| 4. Zj. Ersila Çukaj
<i>Ersila Çukaj</i> | 5. Zj. Drita Çukaj
<i>Drita Çukaj</i> | 6. Z. Mirash Çelaj
<i>Mirash Çelaj</i> |
| 7. Z. Robert Preknica
<i>Robert Preknica</i> | 8. Z. Ardit Vulaj
<i>ARDIT VULAJ</i> | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR
NOTER EURELA . MUJAJ**

**DATE 11/04/2021
NR REP 1278**



V2021040210063797130



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 11.04.2021, para meje Notere Dr. EURELA . MUJAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Shkoder, Blv .Skenderbeg, Rr.Edith Durham, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Pjeter Çukaj, atësia Lucë, amësia Drande, shtetas Shqiptar, lindur në Dedaj, Shkodër dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Kronit 03700030; Nd. 4; H. 1; Shkrel; Dedaj; 4305; Malësi E Madhe, lindur më 22/05/1963, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033141531 dhe nr. personal G30522060P , .

NËNSHKRUES/IT:

Roland Kalaj, atësia Lekë, amësia Hanë, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Kamic Flake 03690036; Nd. 10; H. 1; Qendër; Kamicëflakë; 4303; Malësi E Madhe, lindur më 17/05/1985, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035111115 dhe nr. personal I50517055E , .

NËNSHKRUES/IT:

Elvis Çukaj, atësia Pjeter, amësia Drita, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Dedaj; Nd. 059; Shkrel; Dedaj; 4305; Malësi E Madhe, lindur më 24/03/1997, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032409288 dhe nr. personal J70324040M , .

NËNSHKRUES/IT:

Ersila Çukaj, atësia Pjeter, amësia Drita, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Kronit 03700030; Nd. 4; H. 1; Shkrel; Dedaj; 4305; Malësi E Madhe, lindur më 10/05/2002, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033668257 dhe nr. personal K25510034C , .

NËNSHKRUES/IT:

Drita Çukaj, atësia Nush, amësia Mrikë, shtetas Shqiptar, lindur në Vukpalaj, Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Dedaj; Nd. 059; Shkrel; Dedaj; 0000; Malësi E Madhe, lindur më 05/05/1972, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036737970 dhe nr. personal H25505111L , .

NËNSHKRUES/IT:

Mirash Çelaj, atësia Pjeter, amësia Leze, shtetas Shqiptar, lindur në Goraj, Shkoder dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Goraj Shkoder; Kastriot; 0000; Malësi E Madhe, lindur më 16/03/1971, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027521443 dhe nr. personal H10316043L , .



V2021040210063797130

NËNSHKRUES/IT:

Robert Preknica, atësia Mark, amësia Margarita, shtetas Shqiptar, lindur në Koplik, Malësi e Madhe dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Bzhete; Nd. 048; Shkrel; Bzhetë; 0000; Malësi E Madhe, lindur më 13/03/2000, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033613685 dhe nr. personal K00313039Q , .

NËNSHKRUES/IT:

Ardit Vulaj, atësia Ndue, amësia Groshe, shtetas Shqiptar, lindur në Koplik, Malësi e Madhe dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Vrithë; Shkrel; 0000; Malësi E Madhe, lindur më 25/04/1999, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033231919 dhe nr. personal J90425025C , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut "Juljano 13 Medicinal", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

Dr. EURELA . MUJAJ